



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____ .2021

VENDIM
Nr. 296, datë 09.07.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Ersida Bajgora, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 291 i Kodit Penal”.
2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Saemira Hila, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen gjyqësore me Paditës: {...}, etj.; I paditur: {...}, etj.; Objekti: “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”.
3. Gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Miranda Nakaj dhe Arjeta Lika, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen gjyqësore me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Anullim vendimi”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Besnik Shehu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...}, {...};

Akuza: “Kanosje për të mos kallëzuar”, kryer në bashkëpunim, “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga nenet 311 e 25 dhe 236/2 të Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Seladin Pysqyli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...}; Akuza: “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, e kryer në bashkëpunim dhe “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror”, parashikuar nga nenet 109/1 e 25 dhe 297 të Kodit Penal”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Eglantina Mikani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...}; Akuza: “Trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga nenet 283/a/2 e 22 të Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Astrit Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me Kërkuese: {...}; Objekti: “Mosfillim i procedimit penal”, sipas nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Paditës: Personi juridik “{...}; Të paditur: Përmbaues privat {...}, {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: “Kundërshtim veprimesh përmbaresh, anulim i veprimit të përmbareshit {...}, etj.”

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka dhe Iliba Bezati, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Pastrimi i produkteve të veprës penale”.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}, {...}; Kundër: {...}; Objekti: “Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr.381, viti 2018”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni dhe Irena Brahim, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: Shoqëria {...}; Person i tretë: Shoqëria Përmbareshit {...}”; Objekti: “Kundërshtim veprimi përmbareshit”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri dhe Sokol Pina, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: Shoqëria {...}sh.p.k; Person i tretë: Shoqëria Përmbareshit {...}sh.p.k”; Objekti: “Kundërshtim veprimi përmbareshit”.

GJYKATA E POSACME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “neni 257/a/2 i Kodit Penal”.
- II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR